



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 16/1 Prot.

Tiranë, më 29 / 02 / 2024

VENDIM

Nr. 6, datë 29 / 02 / 2024

MBI

**“MIRATIMIN NË FAZË TË DYTË TË LISTËS PËR REDUKTIM NGA TARIFA
VJETORE E SHKOLLIMIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË TË
STUDIMEVE (MASTER) PËR VITIN AKADEMIK 2023-2024 NË UNIVERSITETIN
E ARTEVE”**

Bordi i Administrimit të Universitetit të Arteve, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, në Urdhrin e Rektorit të Universitetit të Arteve nr. 93/1, dt.03.01.2024, “Për fillimin e procedurës së pranimit të aplikimeve dhe shqyrtimit të dokumentacionit (faza 2), nga ana e fakulteteve të UART, për studentët të cilët përfitojnë përjashtim ose reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, për vitin akademik 2023-2024, në Universitetin e Arteve”, bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga studentët aplikues, procesverbaleve nr. 16 prot., datë 09.01.2024 (FM), nr. 16/3 prot., datë 29.01.2024 (FAS), me listat e studentëve aplikantë të përgatitura nga Kryetarja e Degës së Fakultetit të Muzikës dhe Fakultetit të Artit Skenik, pas relatimit të tyre dhe shqyrtimit e diskutimit nga Bordi i Administrimit,

V E N D O S I:

1. Miratimin e listës për reduktim nga tarifa vjetore e shkollimit, të studentëve aplikues renditur në Shtojcën nr. 1 dhe Shtojcën nr. 2¹ bashkëlidhur këtij vendimi që ndjekin studimet në ciklin e dytë të studimeve Master pranë të Fakultetit të Muzikës dhe Fakultetit të Artit Skenik në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2023-2024.

¹ Shtojca nr. 1 dhe Shtojca nr. 2 kanë përmbajtje të njëjtë, me ndryshimin e vetëm se në shtojcën nr. 1 studentët renditen në formatin emër+atësi+mbiemër, ndërsa në shtojcën nr. 2, ata identifikohen me numër matfikutillimi.



2. Ky vendim, së bashku me *Shtojcën nr. 2* (në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar), të përcillet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).
3. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi, Fakulteti i Muzikës dhe Fakulteti i Artit Skenik të Universitetit të Arteve si dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Publikimin e vendimit si dhe *Shtojcës nr. 2* në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


BORDI I ADMINISTRIMIT I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Lavdrim SAHITAJ



(Kryetar)

Prof. Besnik Bisha



(Anëtar)

Jeton SHEHU

(Anëtar)

Prof.Asoc.Dr. Sokol SARAÇI



(Anëtar)

Ergis SEFA

(Anëtar)

Lorenc VANGJELI



(Anëtar)

Vladimir Llakaj



(Anëtar)



Shtojca nr. 2

FAKULTETI I MUZIKËS

Kriteri 2				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA212G120006	Muzikës	Kitarë dhe Mësuesi	1 (parë)

FAKULTETI I ARTIT SKENIK

Kriteri 4				
Nr.	Numri i matrikullimit	Fakulteti	Programi i studimit	Viti (1-3)
1	AA214B120029	Artit Skenik	Koreografi dhe Mësuesi	1 (parë)



